



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1176 Prot

Shkodër, më 12 07 .2021

Lënda: Kërkesë për informacion.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Rruga Ibrahim Rugova Nr 4 Tiranë.

Të nderuar,

Në zbatim të shkresës suaj me nr 5653 prot. datë 07.06.2021 protokolluar me tonën nr. 9085 prot. datë 09.05.2021 me lëndë "Transferim fondesh" si dhe në zbatim të Kodit Zgjedhor në RSH nenit 21 Kompetencat e KQZ pika 19 ku citohet se : "KQZ Cakton masën e shpërblimit për anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe anëtarët e grupeve të numërimit " kërkojmë nga ana juaj informacion si më poshtë:

Nga ana juaj janë deleguar fondet për masën e shpërblimeve të KZAZ-ve numer 2,3,4 dhe 5 që janë nën administrim të Bashkisë Shkodër nga ku janë përcaktuar masat e shpërblimeve për çdo grup numërimi si dhe fondi përkatës i ndarë për çdo KZAZ.

Nga verifikimi i listëpagesave të dorëzuara nga ana e KZAZ-ve 2,3,4 dhe 5 janë vërejtur se masa e shpërblimit për GNV-të është dorëzuar e dyfishuar në raport me shumën e akorduar nga ana juaj. Nisur nga kjo kërkojmë informacion më të detajuar nga ana juaj se si janë bërë përlllogaritjet kur është akorduar fondi pasi nga ana e KZAZ-ve është sqaruar qartë që GNV në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 kanë numëruar me dy raunde ku në raundin e parë janë numëruar kutitë e votimit për subjektet politike dhe janë rinumëruar kutitë e votimit për renditjen e kandidatëve në raundin e dytë.

Sipas fondit të akorduar nga ana juaj për masën e shpërblimit për GNV rezulton të jetë llogaritur dhe miratuar fondi vetëm për një raund.

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj në mënyrë që të kemi edhe në një përgjigje për KZAZ-të e Bashkisë Shkodër si dhe anëtarët e GNV-ve në lidhje me masën e shpërblimit të akorduar nga ana juaj.

Duke ju uruar punë të mbarë.


KRYETAR
VOLTANA ADEMI

Konceptoi : D Kraja